



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.982/16

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Lumni Sallauka e Arsim Hamzaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q. (H.) M. nga Gjilani rr. “...” nr..., të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.H.M. nga Gjakova, kundër të paditurit S. (M.) G. nga fshati ... komuna e Suharekës, për shkak të kthimit të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.864/11, të datës 16.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 10.12.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurit S. (M.) G. nga fshati ... komuna e Suharekës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.864/11, i datës 16.11.2015, **VËRTETOHET**, përveç pjesës për kamatën e gjykuar, në të cilën pjesë i njëjti aktgjykim **NDRYSHOHET** dhe **gjykohet** me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar e cila paguhet nga bankat komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 16.11.2015, e deri në pagesën definitive.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.864/11, të datës 16.11.2015, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit Q. M. nga Gjilani dhe është obliguar i padituri S. G. nga fshati ..., që në emër të borxhit t’ia kthej paditësit shumën prej 3500 euro, me kamatë ligjore për aq sa paguajnë bankat për mjetet e afatizuara për një vit, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Po ashtu është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, i padituri ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ankesën e tij ta aprovoi si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar përgjigje në ankesë duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ankesën e të paditurit ta refuzoi si të pa bazuar kurse aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e të paditurit, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 14.12.2011, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për kthimin e borxhit dhe shpërblimin e dëmit, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.864/11, të datës 16.11.2015, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar. Në arsyetim është theksuar se pas analizimit të provave është ardhur në përfundim se i padituri me veprime të pandërgjegjshme ka arritur që nga paditësi të huazojë në emër të borxhit shumën prej 3500 euro, të cilën shumë nuk i'a kishte kthyer, e të cilin fakt gjykata e ka vërtetuar nga deklarata e paditësit si dhe nga provat materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilave edhe ua ka falur besimin e plotë. Me rastin e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 562 të Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ku mbi bazën e kësaj gjendje edhe është aprovuar si e bazuar kërkespadia e paditësit. Andaj pretendimet e të paditurit për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe të drejtë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që

t'i përsëris edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave materiale - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Me nenin 562 të LMD parashihet se *“huamarrësi ka për detyrë që në afatin e kontraktuar t'i kthejë sendet e marra hua në sasi e në cilësi të njëjtë”*, kurse me nenin 262 të LMD parashihet se *“kreditore në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e bazuar dhe atë për shumën sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Për kamatën gjykata e shkallës së dytë ka vendosur zyrtarisht dhe në pajtim me dispozitat e nenit 277 al.1 të LMD së zbatueshëm për këtë rast (1978), duke e gjykuar të njëjtën në lartësinë që e paguajnë bankat vendore si për deponimet për kursim me afat mbi një vit, pa destinim të caktuar, ashtu që e njëjta do të fillojë të llogaritet nga data 16.11.2015, kur është marrë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e deri në pagesën definitive.

Drejtë është vendosur edhe në raport me shpenzimet e procedurës dhe në pajtim me dispozitën e nenit 452.4 të LPK.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.982/16, me datën 10.12.2019**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**